



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera
Office of the Prime Minister

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2019





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

VLERËSIM

Popullsia e Kosovës 2019

Prishtinë
Qershor, 2020

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)
Data e botimit: Qershor, 2020
© : Agjencia e Statistikave të Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ASK-së
në internet <http://ask.rks-gov.net/>

Parathënie

Vlerësimi i popullsisë së Kosovës është raport i rregullt vjetor që si qëllim ka të sigurojë një vlerësim statistikor mbi popullsinë, i nevojshëm për institucione, organizata dhe individë, njëherit praktikë dhe standard që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi.

Pasi që në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve (dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi, komune a vendbanimi dhe vlerësimi i popullsisë është më se i nevojshëm për nxjerrjen e indikatorëve të rëndësishëm socio-ekonomik. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) do të vazhdojë të bëjë vlerësimin, çdo vit, të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune. Të dhënat vjetore statistikore mbi popullsinë janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash me çështjet sociale dhe ekonomike në nivele të caktuara komunale, kombëtare dhe rajonale.

Të dhënat mbi popullsinë janë një emërues dhe tregues i rëndësishëm i vendimmarrësve, analistëve, hulumtuesve dhe shfrytëzuesve të ndryshëm të të dhënave. Të dhënat mbi popullsinë përbëjnë komponentin thelbësor për vlerësimet e llogarive kombëtare, punësimit, ndarjeve buxhetore, standardit jetësor dhe çështjeve të tjera socio-ekonomike.

Raporti është përgatitur nga:

Avni Kastrati Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale
Valdete Navakazi, Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave të Popullsisë
Sanije Uka, Zyrtare e Lartë e Statistikave të Popullsisë
Arijeta Sojeva, Zyrtare e lartë e Statistikave të Popullsisë
Elvira Tahiri, Zyrtare e Statistikave të Popullsisë
Vjollca Berisha, Zyrtare e Statistikave të Popullsisë

Prishtinë, Qershor 2020

Kryeshefi Ekzekutiv i ASK-së,
Isa Krasniqi

Lista e shkurtesave dhe simboleve

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
RAE	-	Rom, Ashkali dhe Egjiptian
MPB	-	Ministria e Punëve të Brendshme
IOM	-	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
UNHCR	-	Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
EUROSTAT	-	Zyra Statistike e Bashkimit Evropian
EFTA	-	Asociacioni i Tregtisë së Lirë të Evropës
0	-	E dhëna është më e vogël se 0,5 e njësisë së dhënë të matjes
:	-	Mungojnë të dhënat
-	-	Nuk ka dukuri

Përmbajtja

H Y R J E	6
Për shfrytëzuesit e të dhënave	6
Baza mbi vlerësimin e popullsisë	6
Vështrimi metodologjik	6
Burimet e të dhënave	6
Popullsia bazë	7
Lindjet:	7
Vdekjet:	7
Shënim:	7
Shtimi natyror:	7
Migrimi	8
Imigrimi ndërkombëtar:	8
Emigrimi ndërkombëtar:	8
Migrimi kombëtar:	8
Rritja e përgjithshme	8
Tab. 1. Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2018 në nivel të komunave	9
Tab. 2. Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2018	10
Tab. 3. Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2018	11

HYRJE

Për shfrytëzuesit e të dhënave:

Raporti përfshin ndryshimet e numrit të popullsisë (shtimin natyror dhe migrimin) gjatë periudhës 01 janar - 31 dhjetor 2019 në territorin e Kosovës.

Baza mbi vlerësimin e popullsisë:

Në përgatitjen e këtij Vlerësimi, ASK-ja ka aplikuar metodat e praktikuara mbi vlerësimin e popullsisë, që aplikohen nga institucionet statistikore, duke shfrytëzuar burimet e ndryshme.

Baza e të dhënave për ta vlerësuar numrin e popullsisë për vitin 2019, është numri i vlerësuar i popullsisë rezidente në Kosovë, në fund të vitit 2018.

Vështrimi metodologjik:

Për ta vlerësuar numrin e popullsisë rezidente në nivel kombëtar/komunal, popullsia është e ndikuar nga nataliteti, mortaliteti dhe migrimi. (NMM).

Vlerësimi i popullsisë: popullsia bazë + nataliteti – mortaliteti ± migrimi i jashtëm/brendshëm.

Të dhënat e vlerësuara përfundimtare mbi numrin e popullsisë në nivel të komunave janë llogaritur sipas procedurave të mëposhtme:

$$P_n + (N-M)+(I-E)$$

P_n -Numri i banorëve të përlllogaritur për vitin e dhënë/paraprak (2018)

N -Numri i lindjeve të gjalla (Nataliteti), 01 janar-31 dhjetor 2019

M -Numri i vdekjeve (Mortaliteti), 01 janar-31 dhjetor 2019

I - Imigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2019

E –Emigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2019

Burimet e të dhënave:

Janë shfrytëzuar burime të ndryshme statistikore në hartimin e këtij raporti si: Vlerësimi i vitit 2018, baza e të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë 2011, bazat e shënimeve nga Statistikat e Lindjeve dhe Vdekjeve (ASK), të dhënat administrative (përfshi bazat nga hulumtimet e ASK-së) të dhënat nga komunat e Kosovës, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM-Zyra e Kosovës), Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR-Zyra e Kosovës) baza e shënimeve nga Eurostat, Frontex si dhe disa të dhënat preliminare nga shume Institute statistikore ku ishte më i shprehur migrimi kosovar. Po ashtu, janë shfrytëzuar të dhënat e tjera

administrative nga institucionet vendore, anketat, raportet dhe hulumtimet e tjera. Këto të dhëna janë analizuar sipas metodave statistikore, duke shërbyer si instrumente dhe shënime të rëndësishme statistikore për vlerësimin e numrit të popullsisë në nivel vendi dhe në nivel të komunave.

Popullsia bazë:

Sipas “Vlerësimi të popullsisë për vitin 2018” numri i popullsisë rezidente në Kosovë në fund të vitit 2018 është vlerësuar gjithsej 1,795,666 banorë rezident numër i cili është marrur si e dhënë bazike për të vlerësuar numrin e popullsisë për vitin 2019.

Lindjet:

Sipas të dhënave nga baza e shënimeve të ASK-së numri i lindjeve të gjalla (të regjistruara) për vitin 2019 ishte gjithsej 25,895 lindje të gjalla, prej tyre që ishin deklaruar me vendbanim të përhershëm të nënës në Kosovë (rezident) ishin gjithsej, 25,795 lindje. Ky numër i rasteve të lindjeve do të merret si bazë në vlerësimin e popullsisë rezidente në Kosovë.

Vdekjet:

Bazuar në të dhënat nga baza e shënimeve të ASK, numri i vdekjeve (të regjistruara) për vitin 2019, ishte gjithsej 10,560 vdekje prej tyre me vendbanimin rezident në Kosovë ishin 10.501 raste të vdekjeve. Ky numër i rasteve të vdekjeve do të merret si bazë në vlerësimin e popullsisë rezidente në Kosovë.

Shënim:

Tek rastet e lindjeve dhe vdekjeve nga komuniteti serb, një pjesë e tyre e konsiderueshme regjistrohet derisa, një pjesë e tyre (*sidomos komunat në pjesën veriore të Kosovës nuk i regjistrojnë/raportojnë rastet e lindjeve dhe vdekjeve*). Bazuar në shtimin natyror të komunitetit serb në pjesën tjetër të Kosovës dhe në regjion numri i rasteve të lindjeve dhe vdekjeve (*të pa raportuara*) pothuaj është i afërt (*me një shkallë më të lartë të vdekjeve*) por ASK-ja në këtë raport nuk ka bërë vlerësim për komunitetin në fjalë për rastet e pa raportuara (nën-regjistrim) pasi nuk ka devijim statistikor të shprehur e që nuk do të ndikon në të dhënat e vlerësuara në nivel komune dhe aq më pak në nivel vendi.

Vlerësimi i rasteve të lindjeve dhe vdekjeve, përfshi komunitetin serb (*rastet e lindjeve dhe vdekjeve që nuk regjistrohen*) do të bëhet në të ardhmen kur do bëhet ristrukturimi/rishikimi i të dhënave demografike.

Shtimi natyror:

Popullsia e Kosovës gjatë vitit 2019 është rritur për 15,294 banorë.

Migrimi ndërkombëtar:

Imigrimi ndërkombëtar:

Sipas të dhënave nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), komuna, UNHCR, IOM. të dhënat nga disa komuna, të dhënave nga disa institute statistikore dhe të dhënat nga databaza e Eurostatit numri i imigrantëve në Kosovë, gjatë vitit 2019 ishte gjithsej 6,066 banorë. Në këtë numër janë përfshirë të kthyerit / riatdhesuarit, numri i azilkërkuesve të Kosovës që kanë fituar të drejtën e nënshtetësisë, si dhe të gjithë ata persona që kanë leje qëndrimi më shumë se një (1) vit qëndrimi në Kosovë.

Emigrimi ndërkombëtar:

Numri i emigrantëve kosovarë gjatë vitit 2019 është vlerësuar të jetë gjithsej 34,911 banorë përfshirë emigrantët legalë dhe ata ilegalë.

Pjesa dërmuese e emigrantëve për vitin 2019 ishin emigrantët *legal*. Emigrimi legal ishte për shkak të: bashkimit familjar, martesave, gjetja e një vendi pune, shpërngulje të përhershme (kryesisht në shtete fqinje), studime afatgjata me punësim etj. Përveç vendeve të BE-së dhe EFTA-së një numër i kosovare kishte emigruar edhe në vende të tjera kryesisht në SHBA, , Turqi, Kanada dhe vende tjera.

Bilanci i migrimit ndërkombëtar (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2019 ishte -28,845 banorë.

Migrimi kombëtar: gjatë vitit 2019, vlerësohet se një numër i konsiderueshëm i popullsisë rezidente në Kosovë ka ndërruar vendbanimin (komunën) për arsye të ndryshme kryesisht nga vendbanimet rurale në ato urbane dhe sub-urbane. Numri i personave që kanë ndërruar vendbanimin nga komuna e mëparshme (nga një komunë në komunë tjetër-brenda Kosovës) është vlerësuar të jetë gjithsej 9,132 banorë (bazuar në trendin e martesave, lëvizjet në periudhën 5 vjeçare: 2005-2010 të nxjerra nga baza e regjistrimit të popullsisë si dhe numrin e nxënëseve që kanë ndërruar komunën e vendbanimit rezident).

Rritja e përgjithshme: Përkundër rritjes pozitive natyrale të popullsisë, Kosova për vite të tera vazhdon të ketë shkallë negative të migrimit që ndikon në rritjen/zvogëlimin e popullsisë. Gjatë vitit 2019 migrimi neto është vlerësuar të jetë -28,845 banorë.

Popullsia rezidente e Kosovës, për periudhën 01 janar deri me 31 dhjetor 2019 u zvogëlua për -13,551 banorë.

Tab. 1. Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror për vitin 2019 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2018)	Sipas vendbanimit të përhershëm në komunë			Gjithsej popullsia dhe shtimi natyror (31.12. 2019)
			Lindjet / Nataliteti (2019)	Vdekjet / Mortaliteti (2019)	Shtimi natyror (2019)	
1	Deçan	42,070	452	183	269	42,339
2	Gjakovë	94,840	1,272	637	635	95,475
3	Glllogoc	60,970	858	256	602	61,572
4	Gjilan	78,633	1,404	655	749	79,382
5	Dragash	34,245	453	303	150	34,395
6	Istog	40,728	509	276	233	40,961
7	Kaçanik	34,396	417	186	231	34,627
8	Klinë	40,254	620	260	360	40,614
9	Fushë Kosovë	38,944	891	193	698	39,642
10	Kamenicë	29,454	325	233	92	29,546
11	Mitrovicë	69,248	1,140	432	708	69,956
12	Mitr. e Veriut	12,153	94	130	-36	12,117
13	Leposaviq	13,469	41	83	-42	13,427
14	Lipjan	57,707	910	370	540	58,247
15	Novobërdë	7,172	53	50	3	7,175
16	Obiliq	18,660	283	96	187	18,847
17	Rahovec	58,023	797	278	519	58,542
18	Pejë	99,115	1,225	639	586	99,701
19	Podujevë	82,793	1,134	391	743	83,536
20	Prishtinë	214,688	3,245	1,110	2,135	216,823
21	Prizren	192,712	2,620	1,001	1,619	194,331
22	Skenderaj	52,475	734	256	478	52,953
23	Shtime	27,425	367	130	237	27,662
24	Shtërpçë	6,763	85	138	-53	6,710
25	Suharekë	59,058	970	379	591	59,649
26	Ferizaj	104,312	1,696	605	1,091	105,403
27	Viti	47,681	696	254	442	48,123
28	Vushtrri	63,548	1,034	459	575	64,123
29	Zubin Potok	6,642	58	25	33	6,675
30	Veçan	7,394	20	52	-32	7,362
31	Malishevë	57,470	982	206	776	58,246
32	Junik	6,370	54	26	28	6,398
33	Miushe	5,906	91	25	66	5,972
34	Hani i Melezit	9,985	133	55	78	10,063
35	Garancie	12,124	25	10	15	12,139
36	Ranillug	3,809	36	57	-21	3,788
37	Partesh	1,739	30	37	-7	1,732
38	Kllokot	2,691	41	25	16	2,707
Gjithsej		1,795,666	25,795	10,501	15,294	1,810,960

Tab. 2. Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi për vitin 2019 në nivel të komunave

Nr.	Komuna	Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2018)	Migrimi ndërkombëtar (2019)			Migrimi kombëtar (2019)			Bilanci i përgjithshëm i migrimit në nivel të komunave 2019	Gjithsej popullsia dhe migrimi (31.12 2019)
			Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit ndërkombëtar	Imigrimi	Emigrimi	Bilanci i migrimit kombëtar		
1	Deçan	42,070	32	83	-51	134	178	-44	-95	41,975
2	Gjakovë	94,840	397	2,034	-1,637	271	369	-98	-1,735	93,105
3	Glllogoc	60,970	56	937	-881	245	411	-166	-1,047	59,923
4	Gjilan	78,633	535	3,562	-3,027	321	405	-84	-3,111	75,522
5	Dragash	34,245	147	475	-328	65	149	-84	-412	33,833
6	Istog	40,728	164	233	-69	201	170	31	-38	40,690
7	Kaçanik	34,396	59	155	-96	116	227	-111	-207	34,189
8	Klinë	40,254	179	683	-504	230	264	-34	-538	39,716
9	Fushë Kosovë	38,944	356	1,780	-1,424	939	197	742	-682	38,262
10	Kamenicë	29,454	23	1,589	-1,566	144	301	-157	-1,723	27,731
11	Mitrovicë	69,248	152	1,185	-1,033	263	346	-83	-1,116	68,132
12	Mitr. e Veriut	12,153	35	107	-72	7	9	-2	-74	12,079
13	Leposaviq	13,469	98	320	-222	13	11	2	-220	13,249
14	Lipjan	57,707	132	860	-728	274	380	-106	-834	56,873
15	Novobërdë	7,172	32	120	-88	77	43	34	-54	7,118
16	Obiliq	18,660	59	983	-924	166	190	-24	-948	17,712
17	Rahovec	58,023	78	2,102	-2,024	164	268	-104	-2,128	55,895
18	Pejë	99,115	210	1,738	-1,528	291	323	-32	-1,560	97,555
19	Podujevë	82,793	412	1,774	-1,362	163	823	-660	-2,022	80,771
20	Prishtinë	214,688	715	1,722	-1,007	2,280	1,226	1,054	47	214,735
21	Prizren	192,712	562	2,056	-1,494	687	401	286	-1,208	191,504
22	Skenderaj	52,475	78	351	-273	223	531	-308	-581	51,894
23	Shtime	27,425	215	842	-627	155	159	-4	-631	26,794
24	Shtërpçë	6,763	19	43	-24	40	56	-16	-40	6,723
25	Suharekë	59,058	50	2,427	-2,377	195	264	-69	-2,446	56,612
26	Ferizaj	104,312	664	1,126	-462	475	300	175	-287	104,025
27	Viti	47,681	154	698	-544	164	236	-72	-616	47,065
28	Vushtrri	63,548	155	2,185	-2,030	255	322	-67	-2,097	61,451
29	Zubin Potok	6,642	9	35	-26	7	8	-1	-27	6,615
30	Veçan	7,394	14	37	-23	8	11	-3	-26	7,368
31	Malishevë	57,470	207	2,323	-2,116	229	313	-84	-2,200	55,270
32	Junik	6,370	13	57	-44	36	26	10	-34	6,336
33	Miushë	5,906	7	145	-138	4	4	0	-138	5,768
34	Hani i Melezit	9,985	9	53	-44	46	52	-6	-50	9,935
35	Garancie	12,124	24	52	-28	208	133	75	47	12,171
36	Ranillug	3,809	4	10	-6	10	7	3	-3	3,806
37	Partesh	1,739	2	9	-7	6	5	1	-6	1,733
38	Klllokot	2,691	9	20	-11	20	14	6	-5	2,686
Gjithsej		1,795,666	6,066	34,911	-28,845	9,132	9,132	0	-28,845	1,766,821

Tab. 3. Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2019 në nivel të komunave

Nor.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2018)	Shtimi natyror (2019)	Bilanci i migrimeve (2019)	Rritja e përgjithshme për vitin 2019	Gjithsej popullsia e Kosovës e vlerësuar për vitin 2019 (31 dhjetor 2019 apo 01 Janar 2020)
1	Deçan	42,070	269	-95	174	42,244
2	Gjakovë	94,840	635	-1,735	-1,100	93,740
3	Glllogoc	60,970	602	-1,047	-445	60,525
4	Gjilan	78,633	749	-3,111	-2,362	76,271
5	Dragash	34,245	150	-412	-262	33,983
6	Istog	40,728	233	-38	195	40,923
7	Kaçanik	34,396	231	-207	24	34,420
8	Klinë	40,254	360	-538	-178	40,076
9	Fushë Kosovë	38,944	698	-682	16	38,960
10	Kamenicë	29,454	92	-1,723	-1,631	27,823
11	Mitrovicë	69,248	708	-1,116	-408	68,840
12	Mitr. e Veriut	12,153	-36	-74	-110	12,043
13	Leposaviq	13,469	-42	-220	-262	13,207
14	Lipjan	57,707	540	-834	-294	57,413
15	Novobërdë	7,172	3	-54	-51	7,121
16	Obiliq	18,660	187	-948	-761	17,899
17	Rahovec	58,023	519	-2,128	-1,609	56,414
18	Pejë	99,115	586	-1,560	-974	98,141
19	Podujevë	82,793	743	-2,022	-1,279	81,514
20	Prishtinë	214,688	2,135	47	2,182	216,870
21	Prizren	192,712	1,619	-1,208	411	193,123
22	Skenderaj	52,475	478	-581	-103	52,372
23	Shtime	27,425	237	-631	-394	27,031
24	Shtërpçë	6,763	-53	-40	-93	6,670
25	Suharekë	59,058	591	-2,446	-1,855	57,203
26	Ferizaj	104,312	1,091	-287	804	105,116
27	Viti	47,681	442	-616	-174	47,507
28	Vushtrri	63,548	575	-2,097	-1,522	62,026
29	Zubin Potok	6,642	33	-27	6	6,648
30	Veçan	7,394	-32	-26	-58	7,336
31	Malishevë	57,470	776	-2,200	-1,424	56,046
32	Junik	6,370	28	-34	-6	6,364
33	Miushë	5,906	66	-138	-72	5,834
34	Hani i Melezit	9,985	78	-50	28	10,013
35	Garanie	12,124	15	47	62	12,186
36	Ranillug	3,809	-21	-3	-24	3,785
37	Partesh	1,739	-7	-6	-13	1,726
38	Klllokot	2,691	16	-5	11	2,702
Gjithsej		1,795,666	15,294	-28,845	-13,551	1,782,115

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

312(496.51)“2019” (084.2)

Vlerësim : popullsia e Kosovës 2019 / raporti është përgatitur nga: Avni Kastrati... et al. - Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2020. – 13 : ilustr. ; 28 cm.

1.Kastrati, Avni

ISBN 978-9951-22-648-6